ИНСТИТУТ ЗА СТАНДАРДИЗАЦИЈА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
INSTITUTI PËR STANDARDIZIM I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Бр.-Nr. 03-865/3
19.10.2026 год.
Скопје-Shkup

DPS
Nr 364 Dos6
Dt. 23.10.2026 Vt.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

INSTITUTIT TË STANDARDIZIMIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

dhe

DREJTORISË SË PËRGJITSHME TË STANDARDIZIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Instituti i Standardizimit të Republikës së Maqedonisë së referuar më poshtë si "ISRSM", njëra palë, dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit e Republikës së Shqipërisë referuar më poshtë si "DPS", pala tjetër

ku në vazhdim ky tekst u referohet si "Palët"

të cilët,

duke qenë plotësisht të ndërgjegjshëm për ndikimin pozitiv që kanë standardet dhe proçedurat e vlerësimit të konformitetit në zhvillimin e ekonomisë dhe tregtisë rajonale,

në mënyrë që të eliminojnë barierat teknike në tregti ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë, dhe për të rritur nivelin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit publik, si dhe mbrojtjen e mjedisit,

duke patur qëllimin për një bashkëpunim reciprok në fushën e standardizimit, në zbatim të parimeve dhe rregullave të adoptuara nga organizatat Evropiane e ndërkombëtare në këtë fushë,

duke marrë në konsideratë rëndësinë e aktiviteteve në fushën e standardizimit dhe në fushën e vlerësimit të konformitetit ndaj kërkesave të standardeve, për të promovuar marrëdhëniet dhe ndihmën reciproke të të dy vendeve,

duke marrë në konsideratë Marrëveshjen CEFTA të vitit 2006, ANEKSIN 1, Kapitullin IV, Nenin 13, i cili i referohet bashkëpunimit rajonal, bazuar në kompetencat dhe funksionet e tyre, kanë rënë dakord për krijimin e një bashkëpunimi dypalësh, dhe

duke synuar të mbështesin përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian,
në përputhje me legjislacionin kombëtar,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Marrëveshja midis të dyja palëve do të përfshijë shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencës në fushën e standardizimit, lidhur me:

1. zbatimin e standardeve dhe shkëmbimin e tyre;
2. promovimin e rrolit të Standardeve Evropiane (EN) në përgjithësi dhe të standardeve të harmonizuara në veçanti për zbatimin e Direktivave të Afrimit të Ri; për të lehtësuar heqjen e barierave teknike në tregti;
3. mbështetjen reciproke dhe shkëmbimin e informacionit lidhur me plotësimin e kritereve për t'u bërë anëtarë me të drejta të plota në CEN dhe CENELEC;
4. organizimin e punës në standardizim;
5. zbatimin e detyrimeve të OBT në fushën e standardeve; dhe

6. përdorimin e teknologjisë kompjuterike në hartimin dhe adoptimin e standardeve dhe bazës së të dhënave (databases).

Neni 2

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e standardizimit, zbatimit të proçedurave dhe rregulloreve të brendshme, si dhe lidhur me pjesëmarrjen e tyre në proçesin e standardizimit në nivel Evropian e ndërkombëtar, duke përfshirë:

1. promovimin e rrolit të EN-ve në përgjithësi dhe të standardeve të harmonizuara në veçanti për zbatimin e Direktivave të Afrimit të Ri; për të lehtësuar heqjen e barierave teknike në tregti;
2. plotësimin, kur kërkohet, të nevojave të bizneseve vendase në territoret respektive të palëve për standarde dhe materiale të tjera në fushën e standardizimit, duke patur parasysh të drejtën e pronësisë intelektuale të palëve, parashikimet e Guidës 10 të CEN/CENELEC Guide 10 "Udhëzues për shpërndarjen dhe shitjen e publikimeve të CEN/CENELEC", dhe Guidën 12 të CEN/CENELEC "Koncepti i Affiliate në CEN dhe CENELEC", si dhe parashikimet e kësaj Marrëveshjeje dypalëshe.

Neni 3

Duke konsideruar rëndësinë e përputhshmërisë me standardet, për lehtësimin e tregtisë reciproke midis vendeve, si dhe për të promovuar bashkëpunimin në fushën e standardizimit dhe aktiviteteve që lidhen me të, palët në këtë marrëveshje kanë vendosur gjithashtu fushën e bashkëpunimit në shkëmbimin e informacionit për sa vijon:

- në fushën e vlerësimit të konformitetit ndaj kërkesave të standardeve kombëtare dhe standardeve identike Evropiane e ndërkombëtare,
- lidhur me sistemet e vlerësimit të konformitetit;
- lidhur me aplikimin e markës së konformitetit.

Neni 4

Bashkëpunimi ndërmjet palëve do të kryhet në mënyrën si vijon:

1. shkëmbimit reciprok të dokumentave normative dhe dokumentave të tjera në fushën e standardizimit,shkëmbimi i standardeve të përkthyera dhe i dokumenteve të standardizimit në gjuhën shqipe;
2. vizita reciproke të ekspertëve me qëllim shkëmbimin e eksperiencës, trajnimin, konferencave, etj;
3. pjesëmarrjen e ekspertëve të ftuar nga DPS dhe ISRSM për seminare, konferenca dhe aktivitete të tjera të ekspertëve që do të organizojnë të dyja palët.

Detajet e mëtejshme dhe ato financiare lidhur me aktivitetet e parashikuara në këtë nen do të jenë subjekt i kontratave të veçanta midis palëve.

Neni 5

Të dyja palët në mënyrë periodike, të paktën një herë në vit, do të përcaktojnë dhe miratojnë programet për bashkëpunimin në projekte konkrete.

Programet periodike/vjetore do të firmosen në mënyrë të alternuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Republikën e Shqipërisë. Rruga dhe mënyra se si do firmosen ato do të jetë subjekt i një miratimi paraprak nga të dyja palët.

Palët, nëse del e nevojshme, do të krijojnë grupe pune të përbashkëta për realizimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Palët do të sigurojnë konfidencialitetin e duhur për dokumentat dhe informacionin e marrë të parashikuar në këtë Marrëveshje.

Dokumentacioni dhe informacioni mund të shpërndahet tek palët e treta vetëm duke marrë më parë me shkrim miratimin e të dyja palëve.

Informacioni lidhur me diskutimet dhe rezultatet nga diskutimet mund të bëhet i njohur vetëm mbas konsultimeve dhe miratimit më parë të palëve.

Neni 7

Kjo Marrëveshje nuk do të ketë ndikim mbi të drejtat dhe detyrimet që do të rezultojnë nga marrëveshjet e firmosura nga palët dhe organiztatat e tyre me vende të tjera.

Neni 8

Ndryshimet dhe shtesat në këtë Marrëveshje do të bëhen me miratimin e të dyja palëve, me anekset në kontrata dhe do të hyjnë në fuqi ditën e firmosjes nga palët.

Neni 9

Kjo Marrëveshje është firmosur për një periudhë të pacaktuar kohore dhe do të hyjë në fuqi ditën e firmosjes nga palët.

Sejcila palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje, duke informuar më parë me shkrim palën tjetër.
Kjo Marrëveshje mbaron vlefshmërinë e saj brenda 3 (tre) muajve nga dita e marrjes së këtij lloj njoftimi.

Neni 10

Kjo Marrëveshje do të hartohet në gjuhën Maqedonase, Shqipe dhe Angleze. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje lidhur me interpretimin e të dyja gjuhëve ose të ndonjë mos përputhshmërie midis tyre, do të mbizotërojë gjuha Angleze.

Të gjitha rastet e mos përputhshmërive lidhur me interpretimin dhe plotësimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen me konsultime dhe negociata të përbashkëta midis palëve.

Bërë në Tiranë në 20.10.2026, në dy kopje, sejcila në gjuhën Maqedonase, Shqipe dhe Angleze, secila prej tyre autentike me vlerë të njëjtë.

Vendi Tirana, 20.10.2026

Për Institutin e Standardizimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut Gazmend Aliu, Drejtor	Për Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit të Republikës së Shqipërisë Riza Hasanaj, Drejtor i Përgjithshëm